



Komuna e Shtimës

Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / 11 / 14

Datë 18 / 06 / 2020

KONTRATË PËR FURNIZIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson: Muhadin Halili , Drejtor i Prokurimit në njëren anë:

dhe

AWA SH.P.K., Rruga "Ilaz Kodra" dardani, 10.000, Prishtina, që e përfaqëson i autorizuari, **Albert Kosumi** tel. 048-477-666 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

Furnizimi me tepih, perde, për institucionet e Komunës së Shtimes

Numri i Prokurimit 617-20-2467-1-3-6

Numri i Brendshëm i Prokurimit 617-2020-023-136

Neni 1 Lënda

Lënda e kontratës do të jetë

Furnizimi me tepih, perde, për Institucionet e Komunës së Shtimes

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 18.06.2020 dhe përfundon me 18.12.2020

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë : *Institucionet e Komunës së Shtimes*

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 2,265.00 €
(Dymijë e dyqindë e gjashtëdhjetë e pesë euro)

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgese (Faturë) nga OE dhe raporti i Menaxherit të Kontratës të caktuar nga AK për furnizimin e kryer .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për NA

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet të kryej ndonjë ose të gjitha punët brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është

nënshtuar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashttrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetente* në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën *Shqipe* në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Albert Kosumi	Emri:	Muhadin Halik
Pozita:	I Autorizuari	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	18.06.2020	Data:	18.06.2020
Vula:		Vula:	

Specifikacion për Furnizimi me tepih, perde-SHFMU'Skenderbeu"Reçak					
Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Perde për klasa (me montim)	m2	150	8.30	1245.00
Totali					1245.00

Specifikacion për Furnizimi me tepih, perde-SHML'Naim Frashëri'Shtime					
Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Perde palosese kualitet per Zyra (matja te behet ne vend)	m2	11.75	8.00	94.00
Totali					94.00

Specifikacion për Furnizimi me tepih, perde-Administrata Komunale					
Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Perde trak	m2	17	8.00	136.00
Totali					136.00


Specifikacion për Furnizimi me tepih, perde-QKMF-ja					
Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Roleta veneciane me montim	m2	50	11.00	550.00
Totali					550.00

Specifikacion për Furnizimi me tepih, perde-Zyra Kryesore Financiare					
Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	Perde trake per zyre, me montim dhe ngjyra te kalter e qelet	m2	30	8.00	240.00
Totali					240.00

REKAPITULIM

Nr	Pozicioni	Çmimi
1	SHFMU'Skenderbeu"Reçak	1245.00

2	SHML'Naim Frashëri'Shtime	94.00
3	Administrata Komunale	136.00
4	QKMF-ja	550.00
5	Zyra Kryesore Financiare	240.00
Gjithsejt Totali		2265.00

Emri i Kompanisë		
Përfaqësuar Nga:		
Emri & Mbiemri	ALBERT KOSUMI	Albert Kosumi
Pozita	FURNIZUES	Administrat
Nënshkrimi		
Data	18.06.2020	27.05.2020
Vula		

